



Raporti vjetor

2021

Përgatitur nga:
Instituti Riinvest

Prill 2022

Përgatitur nga: Instituti për Hulumtime Zhvillimore Riinvest

Publikuar nga: RIINVEST INSTITUTE Lidhja e Prizrenit nr. 56 Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: + 381 (0)38 244320; 223816 www.riinvestinstitute.org

E drejta e autorit © 2022 nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem rikthimi, ose transmetohet, në çfarëdo forme apo mjete, elektronik, mekanik, fotokopjues, incizues apo ndryshe, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

Përmbajtja

Hyrje	
Për ne	1
1. Studime dhe analiza lidhur me zhvillimet ekonomike dhe bashkëpunimin rajonal	2
2. Transformimi i gjelbër	3
3. Transformimi dixhital: sektori privat dhe ekonomitë familjare	5
4. Qeverisja, transparenca dhe llogaridhënia	8
4.1. Barometri i Prokurimit Publik – xIndex	8
4.2. SELDI – (ang. Southeast Europe Leadership for Development and Integrity; Lidërsipi i Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet)	9
5. Projekte tjera	9
5.1. Sallonet në Riinvest	9
5.2. Mbështetje në zbatimin e Agjendës Kombëtare për Fuqizimin e Grave përmes përpjekjeve të avokimit	10
5.3. Fuqia vendimmarrëse në familjet në Kosovë	11
6. Hulumtimet në terren	11
7. Instituti Riinvest bëhet pjesë e konsorciumeve evropiane për Horizon Europe	13
8. Zhvillimi i tregjeve	13
9. Informacione shtesë	14
10. Pasqyrat financiare (nxjerrë nga raporti i auditimit)	15

Hyrje

Të dashur lexues,

Në vijim ju paraqesim raportin vjetor të Institutit Riinvest për vitin 2021. Puna e sivjetshme e Institutit Riinvest ishte mjaft e ngarkuar dhe përfshin një sërë projektesh dhe programesh. Plani vjetor i ndihmon Riinvest-it të planifikojë më mirë aktivitetet e tij dhe në të njëjtën kohë ofron mundësi për të monitoruar realizimin e aktiviteteve të planifikuara.

Projektet në të cilat është përfshirë Instituti Riinvest ndërlidhen me fusha të ndryshme socio-ekonomike. Për qëllim të prezantimit më të lehtë për lexuesin, ne i kemi grupuar ato në këto fusha: (i) përcjellja e zhvillimeve ekonomike, mjedisit biznesor dhe politikave qeveritare (ii) transformimi i gjelbër; (iii) transformimi dixhital; (iv) qeverisja, transparencja dhe llogaridhënia; (v) projekte tjera; (vi) hulumtime në terren; dhe (vi) zhvillimi i tregjeve. Gjithashtu, raporti paraqet edhe (vii) zhvillime tjera të rëndësishme për Institutin Riinvest si lidhur me pjesëmarrjen e Institutit Riinvest në konsorciume evropiane për projektet Horizon Europe. Në raport janë paraqitur edhe (viii) çështje tjera, si dhe të dhëna lidhur me (ix) pozitën financiare në bazë të raportit të auditorit.

Edhe këtë vit, gjetjet tona nga hulumtimet mbetën një burim i besueshëm për të informuar rekomandime për politikat publike. Përmbajtja jonë vizuale, veçanërisht lidhur me transformimin e gjelbër, ka tërhequr vëmendjen e grupeve të synuara dhe publikut të gjerë. Ky model do të replikohet edhe në programet tjera. Instituti Riinvest gjatë këtij viti ka zbatuar projekte në vlerë rreth 400,000 Euro të siguruar nga donatorë, institucione tjera dhe sektor privat. Të gjitha fondet janë siguruar në baza konkurruese.

Gjatë këtij viti, Instituti Riinvest ka hartuar strategjinë e re afatmesme në një proces konsultativ të brendshëm dhe me partnerë të jashtëm. Ky proces ka evidentuar sfidat dhe mundësitë e Institutit Riinvest që të vazhdoj punën drejt përmbushjes së misionit të tij.

Ne vazhdojmë më të fuqishëm rrugëtimin tonë në vitin 2022. Ju uroj lexim të këndshëm të këtij raporti vjetor.

Përzemërsisht,

Alban Hashani
Drejtor Ekzekutiv

Për ne

Instituti Riinvest është “think-tank” më i vjetër në Kosovë, duke vepruar që nga viti 1995. Misioni i Institutit Riinvest është ‘të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës nëpërmjet dijeve të reja dhe studimeve cilësore’. Instituti Riinvest është i angazhuar në katër fusha kryesore: a) hulumtime dhe avokim; b) zhvillim të tregjeve; c) trajnime dhe edukim; dhe d) hulumtime akademike.

Stafi i Institutit Riinvest përbëhet nga 15 punëtorë me orar të plotë dhe 3 me orar të pjesshëm. Prej tyre, 9 janë të angazhuar si hulumtues me orar të plotë (5 doktorë shkence; 2 magjistra shkence dhe 2 me titull bachelor). Instituti Riinvest ka dhe një rrjet prej 15 bashkëpunëtorëve shkencorë që angazhohen në kapacitete të ndryshme në aktivitetet e Institutit Riinvest (12 doktorë shkence; 2 studentë të doktoratës; 1 magjistër shkence). Bordi i Institutit Riinvest përbëhet nga shtatë (7) anëtarë: z. Sejdi Osmani, kryesues dhe anëtarët: Dr. Selman Selmanaj, Dr. Valentin Toçi, Dr. Gresa Latifi, Dr. Petrit Gashi, Dr. Isuf Berisha dhe znj. Rina Malësori.

Vizioni i Institutit Riinvest për periudhën 2030/2035 është që ...’Si lider i studimeve zhvillimore në vend, Instituti Riinvest ka arritur që nëpërmjet partneritetit me institutet me renome në BE e më gjerë të realizojë projekte të standardeve të larta ndërkombëtare duke internacionalizuar produktet dhe shërbimet e tij në fushën e studimeve, edukimit dhe promovimit të diturive të reja’...

Duke synuar përmbushjen e misionit dhe arritjen e vizionit, objektivat strategjike të Institutit Riinvest për periudhën 2022 -2027 janë:

- Ngritja e mëtejme e kapaciteteve strategjike, profilit kërkimor dhe aftësive konkurruese të Institutit Riinvest dhe stafit të tij për të trajtuar problemet kyçe dhe prioritare të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e social sipas kërkesave dhe standardeve Evropiane;
- Ndërtimi i aleancave dhe partneritetit strategjik me organizatat hulumtuese dhe think tank në BE e më gjerë, depërtimi suksesshëm në financimin e projekteve nga Programet Kornizë të Bashkimit Evropian dhe internacionalizimi i produkteve dhe shërbimeve;
- Forcimi i qëndrueshmërisë financiare dhe rritja e të ardhurave vjetore për së paku 70% dhe diversifikimi i burimeve të të ardhurave;
- Brendim i së paku 2-3 produkteve;
- Ngritja e cilësisë së marrëdhënieve me publikun, përmirësimi i komunikimit, rritja e prezencës në media.

1. Studime dhe analiza lidhur me zhvillimet ekonomike dhe bashkëpunimin rajonal

Gjatë vitit 2021, Instituti Riinvest ka bërë analizën e Programit Qeveritar dhe implikimet e tij buxhetore, bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, si dhe ka dhënë rekomandime se si të harmonizohen politikat buxhetore dhe fiskale me prioritetet e programit buxhetor. Gjithashtu Riinvest i ka dërguar kabinetit qeveritar Analizën e tij të pagave në sektorin publik me rekomandime përkatëse se si të ndërtohen politika të qëndrueshme në këtë fushë.

Në bashkëpunim me Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur, Instituti Riinvest ka hartuar analizën gjithëpërfshirëse "Bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor" të cilën gjithashtu e ka debatuar në një tryezë me pjesëmarrje të ekspertëve dhe palëve tjera të interesit. Tryeza është transmetuar drejtpërdrejtë edhe në rrjetet sociale.

Gjatë vitit 2021, Instituti Riinvest ka riaktualizuar diskutimin lidhur me pasojat e pandemisë COVID 19 dhe skenarët e rimëkëmbjes. Në këtë kuadër janë diskutuar gjetjet e raporteve në vijim, të hartuar në fund të vitit paraprak: (i) Bashkëjetesa me COVID 19: tri shtyllat e rimëkëmbjes; (ii) Implikimet Ekonomike dhe Sociale Të COVID-19: Kosova dhe Ballkani Perëndimor; (iii) Pakoja Fiskale Emergjente: Implikimet dhe sfidat e zbatimit, dhe (iv) Skenarët lidhur me COVID 19 dhe rimëkëmbja shëndetësore ekonomike.




2. Transformimi i gjelbër

Në kuadër të aktiviteteve të tij, Instituti Riinvest gjatë vitit 2021 ka lansuar një program të ri lidhur me transformimin e gjelbër. Bashkimi Evropian përmes Marrëveshjes së Gjelbër synon që deri në vitin 2050 ta bëjë Evropën rajon me

zero emetim të karbonit. Në këtë kontekst, dhe me iniciativën e BE-së, edhe Ballkani Perëndimor (BP) po bën përpjekje që të jetë kontribuues aktiv në këto iniciativa. Agjenda e Gjelbër e BP-së, që është edhe zotim zyrtar i këtyre vendeve, synon që përmes zbatimit të një sërë masash dhe koordinimit me BE-në të reformojë sektorin energjetik, eliminoj ndotjen, dekarbonizojë ekonominë, ruaj biodiversitetin, dhe promovojë ekonominë qarkore. Përballë këtij sfondi, përpjekjet tona në Institutin Riinvest ishin që të kontribuojmë në ngritjen e vetëdijes dhe cilësisë së diskutimit lidhur me këto çështje dhe të promovojmë politikë bërjen e bazuar në evidencë.

Në këtë kontekst Instituti Riinvest me mbështetjen e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur ka themeluar një platformë të titulluar GAS (ang. Green Action Space; Hapësira për Veprim të Gjelbër). Në kuadër të GAS janë paraparë tre shtylla: (i) shkolla e gjelbër; (ii) kërkimet; dhe (iii) avokimi. Gjatë vitit 2021, Instituti Riinvest ka formësuar GAS-in si një qendër me identitet vizual të saj dhe hapësirë e infrastrukturë adekuate për këtë qëllim. Gjithashtu, GAS ka faqen e saj zyrtare në rrjetet sociale ku ka mijëra ndjekës.

Gjatë vitit 2021, Instituti Riinvest ka organizuar ciklin e parë të shkollës së gjelbër. Një cikël ka gjithsej 12 ligjërata dhe dy punëtori jashtë vendit, brenda 14 javëve. Interesimi i kandidatëve për të marrë pjesë në shkollë ka qenë shumë i madh dhe përbërja e klasës së parë të shkollës ka qenë në linjë me synimet tona fillestare. Kjo shkollë ka për qëllim parësor që të rrisë vetëdijen dhe pajis me njohuri përfaqësuesit e shoqërisë civile, politikbërësve, dhe bizneseve, lidhur me çështjet mjedisore duke inkurajuar debatin dhe



avokimin në kontekst të Agjendës së Gjelbër. Shkolla e gjelbër është ka një format edukativ ku përfshihen ligjërata, punëtori tematike, diskutime, dhe tryeza. Për më tepër, shkolla gjithashtu ka nxitur diskutime dhe debate në mes të palëve të ndryshme të interesit lidhur me sfidat dhe implikimet që rrjedhin nga zotimet e Qeverisë së Kosovës lidhur me Agjendën e Gjelbër.



Gjithashtu, në kuadër të GAS do të organizohen aktivitete të rregullta avokuese “Green Talks” që kanë për qëllim informimin e politikave publike përmes diskutimeve dhe debateve të mirë informuara, si dhe analizave tematike për ndikimin socio-ekonomik të zotimeve që dalin nga Agjenda e Gjelbër e Ballkanit Perëndimor.

3. Transformimi dixhital: sektori privat dhe ekonomitë familjare


Në kuadër të fushës së ndërlidhur me dixhitalizimin, Instituti Riinvest, gjatë vitit 2021, ka filluar zbatimin e dy projekteve kërkimore (i) fokusuar në kapacitetet dixhitale të industrive përpunuese në Kosovë, (ii) lidhur me vlerësimin e gatishmërisë dixhitale të Kosovës në nivel të ekonomive familjare. Gjithashtu, në këtë kuadër është zhvilluar një projekt (iii) për mbështetje të bizneseve në pronësi të grave në fushën e dixhitalizimit.

Projekti i parë, lidhur me dixhitalizimin e sektorit privat, ka të bëjë me një studim që do të sigurojë informacionin e nevojshëm bazë rreth burimeve të TIK-ut në dispozicion të bizneseve dhe përdorimit të tij në sektorët kyç të biznesit privat, veçanërisht ata që operojnë edhe në tregjet e eksportit. Ky informacion është shumë i nevojshëm për aktorët përkatës (bizneset dhe shoqatat e biznesit, qeverinë, shërbimet mbështetëse të biznesit në fushën e TIK-ut dhe dixhitalizimit) për të avancuar politikat dhe angazhimet për rritjen e ndërgjegjësimin për potencialet dhe mundësitë për të mbështetur ndërtimin e kapaciteteve konkurruese të shëndosha të bizneseve përmes dixhitalizimit të biznesit.

Për qëllimet e këtij studimi, janë analizuar katër (4) sektorë të rëndësishëm të biznesit. Numri i sektorëve është përcaktuar në bazë të nivelit të eksportit të sektorit respektiv. Bazuar në të dhënat e Doganës së Kosovës, sektorët me performancën më të mirë të eksportit në katër vitet e fundit janë a) produktet e gomës dhe plastikës b) përpunimi i ushqimit c) prodhimi i mobileve dhe d) përpunimi i metaleve.

Instituti Riinvest, në këtë kuadër, ka gjeneruar informacione të vlefshme përmes anketave me rreth 500 ndërmarrje në këta sektorë; grupe të fokusit dhe intervista të thelluara me ekspertë të fushës.

Projekti i dytë kërkimorë ka analizuar përvojat dhe perceptimet e qytetarëve për disponueshmërinë e shërbimeve dixhitale publike dhe private, përballueshmërinë,




kënaqësinë e qytetarëve me shërbimet ekzistuese online/offline, ndikimin e pandemisë Covid-19 në ofrimin e shërbimeve, aftësitë dixhitale dhe ndarjen dixhitale. Raportet ofrojnë të dhëna dhe tregues cilësorë për dixhitalizimin dhe transformimin dixhital, duke identifikuar nevojat dhe kushtet specifike të nevojshme për të

përshpejtuar me sukses transformimin dixhital të gjithë shoqërisë në Kosovë. Vlerësimi i gatishmërisë dixhitale ka mbledhur perspektiva dhe pikëpamje mbi statusin e procesit të transformimit dixhital të Kosovës. I njëjti bazohet në të dhëna cilësore të grumbulluara me mbi 3,500 amvisëri nëpër Kosovë për të pasur informacione mbi fuqitë dhe mundësitë dixhitale të Kosovës, që do të përdoret së bashku me mjete të tjera dhe kërkime ekzistuese mbi dixhitalizimin. Në përgjithësi, ky projekt kërkimor të kontribuojë në përmirësimin e koordinimit dhe qartësisë për të nxitur një qasje të tërë të qeverisë dhe të gjithë shoqërisë ndaj transformimit dixhital dhe shfrytëzimit dixhital për të arritur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Objektivi i përgjithshëm i raportit ishte t'u ofrojë palëve të shumta të interesuara të dhëna dhe informacione në kohë për gatishmërinë dixhitale, dixhitalizimin dhe transformimin dixhital në nivel komunal, duke shërbyer si një mjet thelbësor analitik për hartimin e strategjisë dhe politikës së Agjendës Dixhitale.


Më e rëndësishmja, rezultatet e anketës ofrojnë të dhëna të detajuara që të kontribuojnë në zhvillimin e agjendës dhe strategjisë dixhitale të Kosovës. Gjithashtu, do t'u mundësojë palëve të interesuara të përshtatin ndërhyrjet e politikave, të zhvillojnë rregullore dhe të ndajnë burime që adresojnë kontekste specifike. Rezultatet e raporteve hulumtuese japin tregues për: 1) Disponueshmërinë e internetit dhe teknologjisë; 2) Pronësinë dhe përballueshmërinë e pajisjeve të TIK-ut dhe internetit; 3) Qasja (Përdorimi i pajisjeve dhe internetit); 4) Aftësitë dixhitale; 5) Përfshirjen dixhitale; 6) Qasjen në e-qeverisjen dhe shërbimet elektronike; 7) Siguria në internet; 8) Raportimi online i rrezikut online; 9) Tranzicioni i gjelbër dhe dixhital. Hulumtimi është realizuar me qytetarët e Kosovës në shtatë (7) regjione: Prishtinë; Mitrovicë; Prizren, Gjakovë; Gjilan; Pejë dhe Ferizaj. Në kuadër të këtij projekti është dizajnuar edhe një platformë për vizualizimin e të dhënave që mund të përdoren nga palë të interesuara.



Projekti i tretë në këtë fushë, “Mbështetja e sipërmarrjeve të grave për transformim dixhital të biznesit” kishte për qëllim informimin dhe ngritjen e kapaciteteve për 10 gra sipërmarrëse në sektor të ndryshëm të cilat kishin paraqitur nevojën për transformim dixhital të biznesit. Përzgjedhja e tyre është realizuar nëpërmjet thirrjes për aplikimin. Me bizneset përfituese fillimisht janë realizuar takime individuale për të bërë një vlerësim të gjendjes lidhur me njohurit e tyre në këtë fushë dhe kapacitetet e tyre në infrastrukturë. Pas



vlërësimit të gjendjes janë përgatitur planet e ligjëratave dhe takimeve individuale me secilin biznes për 6 muaj rreth 150 orë takime për të ofruar ndihmë individuale dhe për trajnimet me ekspert të fushave. Trajnimi në grup është zhvilluar online pas parasysh situatën me COVID-19 dhe janë ofruar ligjëratat për zgjerimin e njohurive të tyre për transformimin dixhital në fushat: a) Marketing, b) Eksport, c) Përdorim të rrjeteve sociale dhe d) Shitje online. Gratë sipërmarrëse përfituese të projektit kanë vlerësuar që transformimi dixhital është mjaftë i rëndësishëm e po aq sfidues kur kemi parasysh se



ato janë të përfshira në biznese të vogla dhe mikro. Ato më tutje kanë vlerësuar se nevoja për transformim dixhital e sidomos komunikimit online dhe shitjes online erdhi si nevojë imediate në kohën e pandemisë COVID-19. Prandaj duke e parë si shumë të nevojshëm këtë zhvillim ato kanë vlerësuar lartë implementimin e projektit nga Instituti Riinvest duke potencuar se nëpërmjet këtij projekti disa nga ato kanë përfituar edhe njohurit bazike, qasjen në rrjete sociale, shkathtësitë për publikimin e produkteve, njohurit lidhur me eksportin dhe kriteret që duhet plotësuar, njohurit për qasje në fonde dhe shitjet online të cilat për momentin në Kosovë sa i përket




bizneseve mikro dhe të vogla realizohen nëpërmjet rrjetet sociale dhe liferimi i produkteve bëhet në mënyre individuale dhe në disa raste ekziston edhe bashkëpunimi me postat e shpejta.

Përfituese të projektit ishin 10 sipërmarrje me sipërmarrëse gra në sektor të ndryshëm si përpunim të çokolatës, pemëve dhe perimeve, tekstil, argjilës, argjend dhe lëkurë, bimë shëruese, konditeri.

4. Qeverisja, transparencja dhe llogaridhënia

4.1. Barometri i Prokurimit Publik – xIndex

‘Barometri i Prokurimit Publik – xIndex’ synon të përmirësojë transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e 38 komunave të Kosovës në prokurimin publik. Qëllimi afatgjatë i projektit është krijimi i një modeli të qëndrueshëm, ose një mjeti krahasues të cilit do t'i referohen komunat, si dhe institucionet kryesore të prokurimit, OJQ-të dhe palët e tjera të interesit. Modeli statistikor ‘xIndex’ mbështetet në të dhëna sasiore, të publikuara nga vetë komunat në platformën 'e-prokurimi', duke mos lënë hapësirë për interpretim subjektiv të gjetjeve.



Metodologjia e ‘x-index’ mbështetet në një metodologji tashmë të konsoliduar dhe të kontekstualizuar nga stafi i Institutit Riinvest që t’i përbrendësojë specifikat e Kosovës. Metodologjia vlerësuese bazohet në nëntë nën-indekse të monitorimit, ku secili prej tyre

përshkruan një çështje të veçantë të prokurimit publik. Në fund, rezultatet e 9 nën-indekseve kombinohen për të prodhuar një vlerë të vetme të x-indeksit, duke përdorur një mesatare të ponderuar, për çdo komunë.

Raporti ‘Barometri i Prokurimit Publik –

xIndex’ është publikuar dhe prezantuar në një konferencë me pjesëmarrjen e palëve të interesit. Gjithashtu, është dizajnuar edhe një platformë interaktive për vizualizimin e rezultateve për tre vitet e shkuar (<https://www.riinvestinstitute.org/Al/x-index/>).



4.2. SELDI – (ang. Southeast Europe Leadership for Development and Integrity; Lidërsipi i Evropës Juglindore për Zhvillim dhe Integritet)

Instituti Riinvest është pjesë e rrjetit SELDI që është një koalicion kundër korrupsionit dhe qeverisjes së mirë i krijuar në vitin 2012 nga 17 organizata në Evropën Juglindore, duke përfshirë partnerë nga nëntë vende. Në kuadër të kësaj platforme, Instituti Riinvest ka qenë i përfshirë në aktivitete të ndërlidhura me:

- Ndërtimin e koalicionit për zhvillimin dhe miratimin e një strategjie rajonale të OSHC-ve dhe agjendës së veprimit;
- Monitorimi i qeverisjes së mirë (përfshirë trajnimet e OSHC-ve, përgatitjen e studimeve krahasuese, Raportet Kundër Korrupsionit specifike për vendin dhe rajonal);
- Ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut (përfshirë Forumet Rajonale të Qeverisjes së Mirë dhe Politikave Kundër Korrupsionit, komunikimin me mediat).

5. Projekte tjera

5.1. Sallonet në Riinvest




Instituti Riinvest në kuadër të projektit “Sallonet në Riinvest” i cili financohet nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, ka organizuar sallonet tematike, me qëllim të informimit, angazhimit dhe nxitjes së debateve mes të rinjve lidhur me temat të ndryshme të karakterit socio-ekonomik.

Qëllimi i këtij projekti ishte organizimi i 3 salloneve tematike, me qëllim të informimit, angazhimit dhe nxitjes së debateve mes të rinjve lidhur me temat e ndryshme të karakterit socio-ekonomik siç janë: (i) efektet e COVID-19 tek të rinjtë (ii) migrimi i të rinjve (iii) orientimi në karrierë. Diskutimet janë zhvilluar ndërmjet të rinjve dhe aktorëve nga komuniteti i

biznesit,

shoqëria civile dhe institucionet publike. Për shkak të rrethanave të shkaktuara nga pandemia, organizimi i këtyre salloneve është bërë përmes platformës google meet. Ideja e organizimit të këtyre ishte që të diskutohet më shumë rreth sfidave të punësimit dhe mundësitë që ofron tregu i punës, përfshirjen e të rinjve në politikë bërje në

Kosovë, si dhe ngushtimin e hendekut mes të rinjve në një anë dhe punëdhënësve në anën tjetër.



5.2. Mbështetje në zbatimin e Agjendës Kombëtare për Fuqizimin e Grave përmes përpjekjeve të avokimit


Qëllimi i projektit, ishte avokimi për avancimit e të drejtave të grave në Kosovë. Objektivi kryesor i projektit ishte shtyrja përpara e diskutimit mbi çështjet më urgjente që ndikojnë në fuqizimin e grave, konkretisht çështjeve të identifikuar në Agjendën Kombëtare për Fuqizimin Ekonomik të Grave. Gjatë projektit janë hartuar katër dokumente pozicionuese në temat:

- Dispozitat ligjore që rregullojnë pushimin e lehonisë
- Inkurajimin e vajzave dhe grave për të zgjedhur profesionet që kanë perspektivë më të mirë në tregun e punës
- Gratë ndërmarrëse në Kosovë
- Qendrat e kujdesit për fëmijë në Kosovë



Këto dokumente pozicionuese më tutje janë prezantuar në katër diskutime publike me palët e interesit si kuvendi, qeveria, shoqëria civile, komunitet të biznesit. Instituti Riinvest ka takuar dhe prezantuar dokumentet pozicionuese në Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime me grupin e grave deputete në kuvendin e Kosovës. Përmbledhja dhe rekomandimet janë publikuar në formë OP-ED

dhe janë publikuar në Sbuker platformë elektronike mediale në Kosovë. Po ashtu ato janë shpërndarë në rrjetet sociale dhe faqet zyrtare të Forumit Ekonomik të Grave dhe Instituti Riinvest. Katër infografika janë përgatitur dhe shpërndarë në rrjetet sociale të Forumit Ekonomik të Grave dhe anëtareve të koalicionit dhe të Institutit Riinvest. Infografikat kanë përcjell mesazhe dhe rekomandime për temat si më lartë.



Nga mbështetësit e projektit kuvendit dhe qeveria janë vlerësuar dokumentet pozicionuese, publikimet në formë OP-ED dhe infografikat si mundësi shtesë për avokimin në ngritjen e vetëdijes në shoqëri kosovare për fuqizimin ekonomik të grave si dhe për trajtimin e tyre me kujdes dhe krijimin e politikave të favorshme si nga qeveria dhe nga kuvendi i Kosovës.

5.3. Fuqia vendimmarrëse në familjet në Kosovë

Instituti Riinvest, në kuadër të projektit SIREd, ka hartuar dhe prezantuar analizën “Nga një këndvështrim gjinor: Kush vendos çfarë në ekonomitë familjare në zonat rurale në Kosovë?”. Hulumtimi analizon fuqinë vendimmarrëse në familjet në Kosovë nga një perspektivë gjinore; gjegjësisht, sa kanë fuqi vendimmarrëse gratë përbrenda institucionit të familjes. Ky hulumtim është nga të parët e kësaj natyre në #Kosovë.



Instituti Riinvest, së bashku me projektin SIREd, ka organizuar tryezë me paltë të interesuara përfshirë Agjencinë për Barazi Gjinore, shoqëria civile, donatorët dhe politikëbërësit. Tryeza ka nxitur diskutim produktiv duke theksuar rëndësinë e gjetjeve të prezantuara. Te gjeturat nga ky hulumtim do të shërbejnë si informata për intervenimet e ardhshme të projektit.



Studimi është fokusuar në dhjetë komuna, përfshirë: Prishtinën, Prizreni, Dragashin, Graçanicën, Suharekën, Vitinë, Kamenicën, Ranilugun, Shtërpçën, and Novobërdën.

6. Hulumtimet në terren

Në kuadër të aktiviteteve të Institutit Riinvest, gjatë vitit 2021, krahas anketave në kuadër të secilit projekt, janë realizuar edhe dy anketa të mëdha për qëllime të projekteve tjera: (i) një anketë në kuadër të projektit “Përkrahja e BE-së për Institucionin e Ombudspersonit” dhe (ii) grumbullimi i të dhënave për sektorin e drejtësisë në Kosovë. Anketa e parë është bërë për qëllimet e projektit në fjalë financuar nga BE-ja dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe i zbatuar nga një Konsorcium i udhëhequr nga DAI/Hulla & Co. Human Dynamics GmbH & Co. KG të cilët kanë mbështetur Institucionin e Ombudspersonit për të forcuar kapacitetin e tij për të rritur dhe ndikuar në efektivitetin në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Anketa ka pasur një mostër përfaqësuese për popullacionin e Kosovës. Përfituesi i drejtpërdrejtë i këtij projekti është Institucioni i Ombudspersonit. Aktivitetet e Institutit Riinvest në këtë kuadër kanë pasur të bëjnë me përkrahjen e projektit për të rritur kapacitetet monitoruese të stafit në kuadër të Institucionit të Ombudspersonit, për të gjurmuar ndërjegjësimin e publikut për mandatin dhe aktivitetet e këtij institucioni. Për më tepër, rezultatet e anketës kanë qenë shumë të dobishme për zhvillimin e fushatës sensibilizuese të duke treguar se në cilat çështje dhe grupe të shoqërisë duhet të fokusohet fushata. Anketa e dytë është realizuar në fushën e sistemit të drejtësisë, veçanërisht në sistemin korrektues të Kosovës. Kjo anketë ka analizuar të gjitha grupet relevante përmes anketave dhe intervistave të thelluara. Anketa ka pasur një mostër përfaqësuese për secilin grup.

Në përgjithësi janë realizuar këto hulumtime në terren, si pjesë edhe e projekteve të cituara në këtë raport:

- Anketa me **4,200** ekonomi familjare realizuar për projektin e gatishmërisë dixhitale në Kosovë (UNDP)
- Anketë me **1,100** ekonomi familjare realizuar për projektin Analiza e ndikimit gjinor në vendimmarrjen brenda familjeve (SIREN)
- Anketë me **1,000** ekonomi familjare realizuar për projektin "Përkrahja e BE-së për Institucionin e Ombudspersonit" (Bashkimi Evropian)
- Anketë me **1,500** respondentë (1,050 ekonomi familjare dhe 450 me pjesëtarë tjerë të sektorit të drejtësisë) lidhur me të dhënat për sektorin e drejtësisë në Kosovë (Ambasada Amerikane)
- Anketë me **1,000** ekonomi familjare realizuar në kuadër të projektit SELDI lidhur me ekonominë informale në Kosovë (SELDI)
- Anketë me **500** biznese prodhuese nga 4 sektorë a) produktet e gomës dhe plastikës b) përpunimi i ushqimit c) prodhimi i mobileve dhe d) përpunimi i metaleve (OEGJK; PCB; EBRD)
- Anketa me **1,400** ekonomi familjare realizuar për nevojat e sektorit privat për matjen e opinionit publik për çështje të ndryshme socio-ekonomike (sektori privat)

Gjithashtu, janë realizuar mbi 50 intervista të thelluara me ekspertë të fushave të ndryshme dhe janë organizuar 15 grupe të fokusit.

7. Instituti Riinvest bëhet pjesë e konsorciumeve evropiane për Horizon Europe

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2021, Instituti Riinvest, në bazë të planit të tij strategjik ka marr masa që të diversifikojë portfolion e projekteve të tij veçanërisht duke ndërtuar partneritet me institute prestigjioze në Bashkimin Evropian dhe në rajon. Instituti Riinvest ka përgatitur dy propozime për Horizon Europe, njërin si lider i konsorciumit e tjetrin si partner në projektin e udhëhequr nga ZSI me bazë në Vjenë. Te dy projektet kanë kaluar kriteret për kualifikim, por në fund është aprovuar vetëm projekti "Policy Answers" që do të realizohet në periudhën 2022- 2026. Kjo gjithësesi paraqet një moment të ri shumë të rëndësishëm për institutin dhe ngritjen e kapaciteteve të tij.



8. Zhvillimi i tregjeve

Instituti Riinvest është bashkë zbatues i projektit Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE) së bashku me SwissContact nga Zvicra. Qëllimi i përgjithshëm i projektit PPSE-së në Kosovë është të fasiltojë funksionimin e NMV-ve dhe fermave që janë në rritje dhe të qëndrueshme në sektorët e ushqimit dhe përbërësve natyralë dhe të turizmit, që ofrojnë mundësi për punë të denjë dhe për të ardhura për gratë dhe burrat në Kosovë. Projekti fokusohet në dy sektorë kryesorë: Ushqimi dhe Përbërësit Natyralë dhe Turizmi.

Përmes temave ndërsektoriale të qeverisjes, barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirës sociale,

projekti fasilton dialogun dhe shërbime këshillimore për aktorët e zinxhirit të vlerave, ndërkohë që eksploron mundësi për angazhimin e grave dhe minoriteteve në përputhje me nevojat e tyre. Mbi bazën e rezultateve dhe mësimëve të nxjerra gjatë Fazës II (2017 - 2021) të projektit, Faza III i qaset zhvillimit të sektorit privat dhe krijimit të vendeve të punës duke e vënë më shumë theksin tek rinia, gratë dhe minoritetet. Financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

9. Informacione shtesë

Gjatë vitit 2021, Instituti Riinvest ka organizuar punën për hartimin e planit strategjik. Procesi i hartimit të planit strategjik ka qenë gjithëpërfshirës dhe konsultativ. I njëjti është aprovuar nga bordi.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021, është aprovuar lista e bashkëpunëtorëve të jashtëm. Me të njëjtit është nënshkruar marrëveshje individuale të bashkëpunimit. Gjithsej janë 15 bashkëpunëtorëve shkencorë që angazhohen në kapacitete të ndryshme në aktivitetet e Institutit Riinvest (12 doktorë shkence; 2 studentë të doktoratës; 1 magjistër shkence).

Gjatë vitit 2021, janë rekrutuar 2 praktikantë nga bashkëpunimi me Millenium Challenge Corporation. Instituti Riinvest është pjesë e rrjeteve rajonale dhe gjatë vitit 2021 ka bashkëpunuar edhe me Institutin Aspen në shkëmbim të përvojave dhe krijim të kontakteve me politikëbërës e fondacione nga Gjermania. Gjithashtu, gjatë vitit 2021, Instituti Riinvest ka rinovuar pajisjet për grumbullim dixhital të të dhënave.

Gjatë vitit 2021, Instituti Riinvest ka organizuar 7 tryeza.

- Në kuadër të projektit Komunitat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse, Instituti Riinvest ka prezantuar raportin kërkimor dhe platformën e x-index-it.
- Në kuadër të projektit të mbështetur nga Fondacioni I Kosovës për Shoqëri të Hapur, Instituti RIINVEST, ka organizuar një tryezë lidhur me raportin kërkimor 'Bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor'.
- Në kuadër të projektit SIREN, Instituti Riinvest ka bashkëorganizuar tryezë për të prezantuar publikimin tone hulumtues "Nga një këndvështrim gjinor: Kush vendos çfarë në ekonomitë familjare në zonat rurale në Kosovë?"
- Në kuadër të iniciativës Human Rightivism të mbështetur nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim e Zhvillim (SIDA) dhe të zbatuar nga Fondi për Zhvillimi të Komunitetit (CDF) Instituti Riinvest ka organizuar 4 takime në çështjet:
 - Dispozitat ligjore që rregullojnë pushimin e lehonisë
 - Inkurajimin e vajzave dhe grave për të zgjedhur profesionet që kanë perspektivë më të mirë në tregun e punës
 - Gratë ndërmarrëse në Kosovë
 - Qendrat e kujdesit për fëmijë në Kosovë

10. Pasqyrat financiare (nxjerrë nga raporti i auditimit)

Pasqyra e pozitës financiare më 31 dhjetor 2021

Pasqyra e të ardhurave dhe fitimit të mbajtur	2021 (€)
Të hyrat	290,309*
Kostoja e shitjes	(37)
Fitimi / (humbja) bruto	290,272
Të ardhurat tjera	65
Shpenzimet e shpërndarjes	(54,488)
Shpenzimet administrative	(235,513)
Shpenzimet e tjera	(336)
Fitimi / (humbja) operativ	0.00

*Nuk përfshin të hyra e shtyra për vitin 2022 në vlerë 103,386 Euro

Bilanci i gjendjes	2021 (€)
PASURITË	
Pasuritë afatshkurtra	
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	90,651
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	6,480
Stoqet	2,586
Pasuritë e tjera afatshkurtra	489
Gjithsej pasuritë afatshkurtra	100,206
Pasuritë afatgjata	
Prona, pajisjet dhe impiantet	13,885
Gjithsej pasuritë afatgjata	13,885
Gjithsej pasuritë	114,091
DETYRIMET	
Detyrimet	
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	10,705
Detyrimet e tjera afatshkurtra	103,386
Gjithsej detyrimet	114,091
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet	114,091

Burimi i të hyrave	Shuma	(%)
Donatorët	236,213	81.4%
Agjenci tjera	42,110	14.5%
Të hyra nga shitja e shërbimeve (sektori privat dhe organizata tjera)	11,986	4.1%
Total	290,309	100.0%